

C.nr.448/2016

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Mirvete Alidema, në çështjen kontestimore të paditësit nga fshati K. , e paraqitur ndaj të paditurve: dhe që të dy nga fshati K. , për kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike me datën 04.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit (pranimit)

DETYROHET i paditurit i parë që paditësit t'ia kompensojnë dëmin material në shumën monetare prej 750 €, ndërsa i padituri i dytë t'ia kompensoj dëmin në shumën prej 100 €, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi , në këtë gjykatë me datën 13.05.2016, ka paraqitur padi ndaj të paditurve: dhe , për kompensimin e dëmit material të cilën dëm e kishin shkaktuar paditësit më datën 26 .09.2015 rreth orës 02:00 kur e kishën thyer derën e lokalit “ ” dhe më pas kishin depërtuar në market dhe kishin marrë gjëra të ndryshme materiale, e që vlera e përgjithme e dëmit kishte qenë në shumë monetare prej 850 euro.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palëve të paditura i'u ka dërguar padinë, në mënyrë që të njëjtit të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e paditësit, njëkohësisht duke i paralajmëruar të njëjtit , që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet në padi, gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë- mosbindjes, nëse plotësohen kushtet ligjore. Por , paditësit edhe pse I kanë pranuar paditë fare nuk janë përgjigjur në padi.

Gjykata, lidhur me këtë çështjes ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 24.10.2018, në të cilën seancë kanë qenë të pranishëm pala paditëse dhe i padituri i parë , ndërsa i padituri i dytë ka munguar edhe pse ftesën për seancë e kishte pranuar me datën 22.06.2018, të njëjtën nuk i është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, dhe me propozimin e palës paditëse seanca është vazhduar në mungesë të të tija.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.10.2018, paditësi në tersi ka mbetur si në përmbajtjen e padisë, ndërsa i padituri , në tersi e ka pranuar padinë dhe kërkesëpadinë e paraqitur nga pala paditëse, duke theksuar që kishte 5 muaj që kishte dalur nga burgu dhe ishte duke jetuar në asistencë sociale nga e cila ishte duke marrë ndihma në shumë monetare prej 133 euro në çdo muaj dhe për momentin nuk kishte mundësi ti'a paguan dëmin por kur do të fillon të punoj do t'ia kompensojë dëmin të cilin ia kishte shkaktuar.

Gjithashtu edhe i padituri i dytë , në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.12.2018, në tersi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar që shumë prej 750 euro, në emër të kompensimit të dëmit, do t'ia paguaj paditësit , pasi që të njëjtit deri tani ia kishte a paguar shumë prej 250 euro, ndërsa shumë tjetër do t'ia paguaj në momentin kur do ti ipet mundësi që të punon.

Në fajlën përfundimtare paditësi , ka deklaruar se meqë i padituri Rizah Hyseni e ka pranuar kompensimin e dëmit ka kërkuar nga ai që shumë prej 750 euro t'ia kompensoj për dëmin që ia

kishin shkaktuar me rastin e thyerjes së marketit të tij, në ditën kur kishin kryer vjedhjen e sendeve në marketin e tij dhe ate pa kamat ligjore, ndërsa për të paditurin e dytë , ka deklaruar se meqë i padituri e ka pranuar dëmin dhe në emër të dëmit ia ka kompensuar një pjesë të dëmit në shumë prej 250 euro, ka kërkuar nga ai që t'ia paguaj borxhin vetëm 100 euro dhe atë deri në muajin janar 2019, ndërsa për pjesën tjetër të dëmit në shumë prej 400 euro, ia ka falur dhe ai nuk i ka kurrfar obligimi ndaj tij përveq shumës prej 100 euro.

Me qëllim të vërtetimit të fakteve të paraqitura në padi dhe pretendimeve të paditësit, Gjykata ka lexuar dhe administruar si prova materiale: Aktgjykimin penal P.nr.1099/2015, i datës 21 dhjetor 2015, i plotfuqishëm me datën 02.02.2016, me të cilën është shpallë fajtor . i, për veprën penale vjedhje e rëndë në bashkëveprim si bashkegzekutor të parashikuar nga neni 327 të KPRK-s dhe Aktgjykimin penal P.nr.1064/2015, i datës 22 tetor 2015, me të cilin është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë të parashikuar nga neni 327 të KPRK-s.

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi dhe provat materiale të bashkangjitura padisë si dhe oohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve dhe i që të dy nga fshati , ka konstatuar që të paditurit me datën 26.09.2015, si bashkëekzekutor kishin kryer vjedhjen në marketin “ , pronar i të cilës ishte paditësi, me qëllim që që ti sjellin vetit pasuri të kundërligjshme, pa autorizim duke thyer deren e lokalit me qrast kishin marrë 10 shtega të cigareve të llojit Winston Blu, dy shteka Boss klasik, një shtek West light, tre shteka Llaki të Kuqe, tre shtega Llaki të bardhë, 6 shteka Ronhill Light, një shtek Kent, një shtek Kamel të Verdhë, tre shteka Slims, dy shteka Malboro të kuqe, dy shtega Malboro të bardhë, katër shteka Ronson, tre shtega Winston Silver, dy shtega Eva Slims, një shtegë Opatia, tre shtega 57-që, dy shtega Prestigj, 25 euro para të metalta, tri pampersa të llojit “Lino”, disa pako me kryp, mbushje të Ipkos në vlerë 15 euro, duke përfshirë dy dyer të cilat i kishin thyer me rastin e vjeshjes, me qka paditësit i kanë shkaktuar dëmin material në shumë të përgjithshme prej 1500 €.

Me këtë gjykata ka konstatuar edhe legjitimitetin real pasiv të palëve në kontest, si dhe të drejtat që janë objekt i këtij raporti civilo-juridik janë në disponimin e të drejtave të palëve, prandaj edhe ka aprovuar kërkesën e paditësit dhe pohimin e kësaj kërkesë nga ana e të paditurve, në bazë të nenit 148 të LPK-së, respektivisht ka marrë Aktgjykim në Bazë të Pohimit.

E drejta e ankesës është përcaktuar në mbështetje të nenit 491.3 të LPK-ës, ashtu që afati është 7 ditë, pas ditës së pranimin të vendimit dhe vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452.4 të LPK-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 143 dhe 148 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtarja,

Mirvete Alidemi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimin të të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.